



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2021

Raport nga mbledhja e III-të e KKSBB për vitin 2021

Takimin e kryesoi Nënkyetari i Komunës së Kaçanikut z. Ylber Bajra me këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
- 3.Inicimi dhe përgjedhja për realizim i një projekti të sigurisë
- 4.Të ndryshme

Në kët takim u diskutua situata e përgjithshme e sigurisë në Komunë në periudhën në mes dy takimeve dhe kanë marrë pjesë të gjithë akterët e sigurisë që janë të përcaktuar me **Udhëzim administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi .**

Në kët takim katër anëtarë të këtij këshilli janë me mëditje prej **50 EURO** dhe kompenzimi i tyre bëhet me pjesmarrjen e tyre në këto takime.

Prezencën këta anëtarë e arsyetojnë me nënshkrim në listën e pjesmarrësve në mbledhjet e KKSBB-së

Këtij reporti ia bashkangjesim edhe **listën e pjesmarrësve** ku për kompenzim janë:

Fidaim Fazliu Jashar Selimi , Remzi Reka dhe Shemsedin Abazi .

Kompenzimi bëhet duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB -03/2012 MAPL për KKSBB-të, neni 18 , Vendimin e Kuvendit Komunal për themelimin e KKSBB-së si dhe në Ligjin Nr.03/L-048

Kaçanik 19.05.2021










Nënkyetari i Komunës z. Ylber Bajra

Lista e pjesmarrjes në mbledhjen e KKSBB-së më datë: 19.05.2021


Nga kjo listë për pagesë janë:

1.Remzi Reka ,2.Shemsedin Abazi,3.Fidaim Fazliu,4.Jashar Selimi

Vërejtje: pagesën e arsyeton vetëm pjesmarrja në mbledhje që e dëshmon duke nënshkruar prezencën


Emri e Mbiemri	Institucioni (organizata)	Nr.i tel.	E-mail	Nënshkrimi
Fidaim Fazliu	EVSIS	044-346-157	fidaim.fazliu20@gmail.com	
Shemsedin Abazi	DCCIM Kosovor	044-160-157	shemsedin.kosovor@telenet.kro	
Jashar Selimi	KBI	044-887-255	fidaim.fazliu2019@gmail.com	
Lekë Rama	FSK	049-898-081	lek.remejebetremi.com	
Remzi Reka	FSK	045 222 828	piteradeli94@gmail.com	
Remzi Reka	OMM Gj	045 538 873		
Jashar Selimi	KËSHILLI PËR INDËRUE	044-164 749	zashar.selimi2019@gmail.com	
Shemsedin Abazi	KLSR	044-224-627	shemsedin.kosovor@gmail.com	
Jashar Selimi	DAK	044-225 357	zashar.selimi2019@gmail.com	
Jashar Selimi	KOMUNA	044-488-662		

Vërtetoi: Kryetari i Komunës

Besim Ilazi 



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2021

Procesverbal

Takimi i II-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021

Më 15.03.2021

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Jaser Jaha, zv. Komandant i Policisë-Kaçanik

Përfaqësuesi i FSK-së

Fadil Guri, Zyra për Komunitete dhe Kthim

Vedat Dema, Zyra për Barazi Gjinore

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Ramadush Osmani, Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Lirije Luta, Komiteti për Komunitete

Jashar Selimi, Këshilli i Prindërve

Fidaim Fazliu, Bashkësia Islame

Zahir Doda, Drejtor i DAK

Me arsyetim mungoi: Remzi Reka

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut z. **Besim Ilazi** i cili prezantoi pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut,
3. Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSB gjatë vitit 2021,
4. Informatë rreth punës së inspektorëve komunal,
5. Identifikimi në teren dhe prezantimi i problemeve urgjente të sigurisë,
4. Të ndryshme.

1.Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar

-Proces verbali u miratua nga të gjithë të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së dytë të rendit të ditës zv.**Komandanti i Policisë** tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile me përjashtim të tri rasteve që duhet përmendur. Në fshatin Doganaj ka ndodhë një vrasje në tentativë me ç'rast një person ka marrë lëndime të lehta .Rasti është marrë nga ekipet e specializuara nga niveli regional. Gjendja e personit të lënduar është e mirë .Është konfiskuar një armë zjarri pa leje një dhe tri të tjera me leje posedim. Gjithashtu një vrasje në tentativë ka ndodhë në fshatin Rekë me ç'rast një person është lënduar rëndë dhe është duke u trajtuar në QKUK. Personat e involvuar në këtë incident janë në arrati dhe ekipet e specializuara nga regjioni janë duke u marrë me rastin. Në fshatin Soponicë ka ndodhur një gjuajtje me armë zjarri, janë arrestuar dy persona dhe është konfiskuar një pistoletë. Angazhimi ynë ka qenë edhe me mbrojtjen e pyjeve e sidomos në pjesën e Parkut Nacional ku nuk ka as roje pylli. Afër fshatit Nikë është konfiskuar një sasi e madhe masë drusore të cilat janë dërguar në parkingun e Invalidëve të Luftës ndërsa rasti u është përcjell prokurorit. Në shkollën fillore „Emin Duraku” ka ndodhur një rrahje në mes dy grupeve të nxënësve të gjinisë femërore dhe janë marrë të gjitha veprimet për këtë rast. Një angazhim të theksuar kemi pasur edhe me menaxhimin e situatës me pandeminë, ku kohëve të fundit kemi pasur rritje të rasteve të infektuarve edhe në komunën tonë dhe ne kemi kryer detyrat tona që na përkasin.

Kryetari: Ka trend të rritjes së të infektuarve në komunën tonë por edhe në mbarë vendin. Nga raporti i nxjerrë ditëve të fundit gjithsej janë 457 raste me COVID-19, 385-që janë shëruar, 58-janë aktiv dhe 48 i kemi me fatalitet. Ne duhet të jemi më aktiv në teren në kryerjen e punëve tona duke e menaxhuar mirë këtë situatë dhe apeloj tek qytetarët të respektojnë masat anti-COVID të vendosura nga IKSHP. Sa i përket çështjes së pyjeve është një situatë shqetësuese sidomos në pjesën e Parkut Nacional që menaxhohet nga niveli qendror kur dihet se Parqet Nationale kanë një tretman të veçantë të mbrojtjes. Ne kemi bërë përpjekje si komunë por që kompetencat i kemi të kufizuara të bëjmë diçka më tepër. Për sot kam thirrur një takim me akterë të ndryshëm për këtë qështje, por që këto takime nuk po e kanë efektin në zgjidhjen e këtij problemi.

Fatmir Qaka: Më intereson të dijë për veprimet policisë për rastin e incidentit në fshatin Rekë, kur dihet se rasti i plagosjes së një personi ka ndodhë si pasojë e një grindjeje një ditë më parë në një kafiteri. Çfarë masa kanë marrë policia në ditën e parë për të mos ndodhë plagosja në ditën e dytë.

Zv.Komandanti: si pasojë e rrahjes që ka ndodhur ditën e shtunë në një kafiteri janë lënduar 4 persona të cilët janë dërguar në spitalin e Ferizajit ku kanë marrë tretman mjekësorë. Pas tretmanit mjekësorë këta persona i kemi marrë në pyetje në stacionin policorë në Kaçanik dhe me procedurë të rregullt janë liruar. Është e vërtetë se rasti i plagosjes ka ndodhur si pasojë e një dite më parë por që me këtë rast janë duke u marrë ekipi i hetimeve në Ferizaj.

Zahir.Doda: ka qenë një rast i publikuar në rrjetet sociale dhe mendoj se shkaktarët kryesorë në shfaqjen e problematikave të tillë nëpër shkolla është mos intersimi i prindërve përfshirë si dhe rrjetet sociale. Problemi qëndron se sa do të jemi ne si shoqëri të i fusim nën kontroll rrjetet sociale. Pjesa që na takon ne si institucion është që të angazhojmë më shumë psikolog nëpër shkolla. Kohëve të fundit duke ju falenderuar edhe Kryetarit i cili i ka përkrahur politikat e DAK-së për angazhim të psikologëve nëpër shkolla, ne kemi punësuar 2 psikolog dhe shumë shpejtë mundë të angazhojmë edhe 2 tjerë. Pra gjendja e sigurisë nëpër shkolla nuk është e mirë si pasojë e mosinteresimit të prindërve, ku disa fëmijë janë dalë jashtë kontrollit prindëror si dhe rrjetet sociale. Masat që na takojnë ne i kemi marrë ku nxënëset e përfshirë në këtë incident do të transferohen në shkollat tjera .

F.Guri: situata e sigurisë në përgjithësi kohëve të fundit nuk është aspak e mirë. Përpara është vepruar në forma të ndryshme përfshirë zgjidhjen e problemeve të llojeve të ndryshme duke përdorë edhe forma morale. Ne duhet të angazhohemi si individ, si shoqëri por edhe si subjekte politike që të gjejmë forma ndërmjetësimi në këto

familje të përfshira në konflikt Gjendja me pyjet është e mjerë , e niveli qendrorë ka bërë një ligj për parqet nationale e interesim për ruajtjen e këtyre parqeve nuk ka. Vitin e kaluar janë djegë 44 hektarë pyll pronë e banorëve të fshatit Nikë dhe këtë vit kanë filluar edhe ti presin pasi që edhe janë tharë. Propozoj por që e di që nuk merret parasysh që të sfidohet qeveria që 44 hektarë pyje në tatim për palujtshmëri të tokës të mos tatimohet. Drurin disa e kanë biznes e disa e kanë për mbijetesë, e që më së shumti po e pësojnë ata që e kanë për mbijetesë. Në rastin e shfaqjes së incidenteve nëpër shkolla është e vërtetë që një faktorë janë edhe rrjetet sociale dhe mendoj se institucionet e sigurisë duhet të kenë qasje për të parandaluar problemet që vijnë si pasojë e rrjeteve sociale.

L.Luta: me një aktivitet që kemi pasur nëpër shkolla, komiteti për komunitete pas një hulumtimi që kemi bërë, kemi parë që bulizmi është prezent nëpër shkolla. Ne kemi konstatuar se faktorë i kësaj dukurie është mosinteresimi i prindërve për të bashkëpunuar me institucionet shkollore. Nxënësit përdorin telefonat në shkollë dhe prindërit nuk interesohen dhe nuk i kanë nën kontroll fëmijët e tyre.

R.Osmani: është absurditet kur në këtë kohë flasim për zgjidhjen e problemeve përmes formave të vjetra siç ka qenë kanuni. Sot ne kemi institucionet e drejtësisë që duhet të merren me këtë çështje Shqetësuese për shoqërinë në përgjithësi është lajmi i arrestimit të zyrtarëve policorë për trafikim të narkotikëve. Kur kjo dukuri shfaqet në institucionet që duhet ta luftojnë këtë dukuri, ne duhet të brengosemi dhe të mendojmë se nga jemi duke shkuar.

Zv.Komandanti: nuk pajtohem me atë se kanë ndodhur 2-3 incidente dhe siguria në përgjithësi nuk është mirë. Mungon vetëdija e qytetarëve që të bashkëpunojnë dhe për të parandaluar të keqën. Angazhimi ynë krahas detyrave të përditshme që kemi ka qenë edhe në mbrojtjen e pyjeve. Një patrullë policore jo rregullisht por që kontrollon pjesën e parqeve nacionale të komunës tonë dhe si rezultat kemi arritur të konfiskojmë një masë të madhe drusore. Edhe për ne ka qenë shqetësuese arrestimi i zyrtarëve policorë të cilët janë marrë me dukuri të cilat vet duhet ti luftojnë. Këta janë zyrtarë policorë nga regjioni i Prishtinës dhe kjo vepër e tyre duhet dënuar.

Kryetari: pajtohem me atë që u tha se në zgjidhjen e problemeve të ndryshme mundë të përdoren edhe forma tjera duke angazhuar individ dhe subjekte tjera, me qëllim të parandalimit të dukurive devijante.

F.Fazliu: nuk mendoj se forma e kanunit mund të zgjidhë probleme. Në të kaluarën kjo formë deri diku ka pasur sukses e diku jo. Ne duhet të shfrytëzojmë autoritetin tonë dhe të ndikojmë në parandalimin e problemeve. Shpesh ka ndodhur që në disa lokalitete kam ndërmjetësuar dhe kam pasur sukses. Shqetësim i imi është vjedhjet që po ndodhin gjithkah e posaçërisht nëpër xhamia . Më brengosë fakti se një person është kapur në lidhje me këtë çështje por që është liruar pa marrë ndonjë dënim të

merituar. Shqetësuese është edhe prania e narkomanëve rrëth hapësirave të xhamive e që mendojë se dikush duhet të i trajtojë këto persona.

J.Selimi: sipas mendimit tim mungon një bashkëpunim në mes policisë dhe qytetarëve në zbulimin e rasteve dhe mendoj që policia duhet të gjejë formë që këtë bashkëpunimin ta ngrisë. Në një takim që kemi pasur me Komitetin për Komunitete, Këshillat e Nxënësve dhe arsimtarëve është vlerësuar lartë angazhimi i dy psikologëve nëpër shkolla si dhe është konstatuar se mungon bashkëpunimi i në trekëndëshin Prind-Arsimtarë-Nxënës dhe ne do të angazhohemi që ky trekëndësh të funksionojë me qëllimin më të mirë për zgjidhjen e çdo problemi që mundë të paraqitet nëpër shkolla.

Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSB gjatë vitit 2020

Kryetari: qëllimi i nxjerrjes së rekomandimeve ka qenë në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve ku disa nga rekomandimet janë zbatuar e disa prej tyre për shkak të rrëthanave të ndryshme nuk janë zbatuar, që mbetet të punohet në të ardhmen.

R.Osmani: shumë nga këto rekomandime të ngjerau nga viti i kaluar bien në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Është punuar në shenjëzimin e rrugëve e ku vlen të theksohet se te Fusha e Pajtimit që është ngritë si shqetësim, së bashku me zyrtarë nga ministria e kemi shqyrtauar këtë problematikë dhe është menduar për një rrëth rrotullim. Ushtrimi i veprimitarive biznesore nëpër trotuare ka qenë një shqetësim dhe ne kemi evidentuar këto vende dhe inspektorati komunal tash e tutje do të merret me këtë punë. Problematika me qentë endacak ka kaluar në nivelin qendrorë, veçanërisht në agjensionin e veterinarisë, është bërë një punë shumë e mirë në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik ku do të vazhdohet edhe në të ardhmen në zgjerimin e këtij rrjeti. Kompania „Pastërtia” ka bërë ndryshim në menaxhment dhe janë parë ndryshime pozitive në kryerjen e shërbimeve. Komuna për çdo vit përmes një kodit të veçantë buxhetor investon në rregullimin e parceve dhe mirëmbajtjen e tyre. Këtë vit do të bëhet edhe zgjerimi i shëtitores në Bulevardin „Ismajl Raka”. Këto ishin disa nga punët që janë bërë nga rekomandimet e nxjerra nga viti i kaluar e që do të vazhdohet të punohet edhe në segmente tjera.

Informatë rrëth punës së inspektorëve komunal

Kryetari: siç jeni të informuar me ndryshimin e statutit komunal, njësiti i inspektorëve ka kaluar në zyrën e Kryetarit dhe për punën e tyre ata i raportojnë kësaj zyre. Deri më tanë inspektorët kanë qenë të shpërndarë nëpër drejtori, ndërsa ata tash kanë një kryeinspektor dhe punët do të shkojnë më mirë. Fjalën po ia jap kryeinspektorit komunal që do të tregoj për punët dhe përgjegjësit e njësitet të inspektorëve.

M.Krasniqi: veprimtaria e njësitet të inspektorëve komunal përfshinë lëmine e tregtisë, ndërtimtarisë, komunikacionit rrugorë, sanitarisë, mbrojtjen e ambientit, shërbimet publike dhe pylltarinë. Për punën e viti të kaluar kam përgatitë një raport të cilin do ua përcjelli edhe përmes E-mail-it.

Identifikimi në terren dhe prezantimi i problemeve urgjente të sigurisë

Kryetari: shumë gjëra u cekën lidhur me problemet urgjente të sigurisë dhe mendoj që ndër problemet aktuale është edhe menaxhimi apo kontrollimi i rrjeteve sociale. Këto rrjete të përdoren për qëllime të mira e jo në nxitjen e urrejtjes dhe shkaktimin e problemeve.

F.Guri: tema e extremizmit radikal si shumë është aktualizuar sidomos nga organizata të ndryshme të cilat fitojnë projekte në emër të luftimit të kësaj dukurie e që në fakt dyshoj se kryejnë punë si duhet.

REKOMANDIMET:

- 1.Të merren masa ndaj rrjeteve sociale që nxisin urrejtje,**
- 2.Të rritet mobilizimi në ruajtjen e pyjeve,**
- 3.Të angazhojmë më shumë psikolog nëpër shkolla,**
- 4.Të mbahen takime më të shpeshta të këshillit të prindërve, këshillit të nxënësve dhe arsimtarëve,**
- 5.Të gjejmë forma ndërmjetësimi në zgjidhjen e problemeve eventuale,**
- 6.Të gjinden forma bashkëpunimi në mes policisë dhe qytetarëve në parandalimin e dukurive devijante,**

Pas këtyre diskutimeve Kryetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës .

Kryesuesi: Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi

Procesmbajtës:

Fatmir Qaka

